



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:177825
Datë: 11.03.2024
Numri i dokumentit: 05476863

Ac.nr.1774/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania e Sigurimeve "Kosova e Re" me seli në rr. "Kalabria", Blloku B 1, nr... në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit A. L. nga Prishtina, kundër të paditurit F. J. nga fshati Dugë, i përfaqësuar nga përfaqësuesi i përkohshëm Sh. S., avokat nga Lipjan, objekti i kontestit rimbursim dëmi, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2/18, datë 12.01.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurit F. J., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2/18, datë 12.01.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.2/18, datë 12.01.2022, gjykata e shkallës së parë ka vendosur: të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve "Kosova e Re" me seli në Prishtinë, kundër të paditurit F. J. nga fshati Dugë, me adresë të panjohur diku në Gjermani, si e bazuar, DETYROHET i padituri F. J., që paditëses Kompania e Sigurimeve "Kosova e Re" me seli në Prishtinë, që për shkak të humbjes së mbulesës siguruese pa patentshofer, t'ia kompensojë shumën prej 2.463.00-€, në emër të shumës së paguar për kompensimin e dëmit palëve të treta të dëmtuara, me kamatë ligjore sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit dt.12.01.2022, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore për përfaqësues së përkohshme në shumë prej 239.20€, dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 30-€, të gjitha këto në afat prej 15

ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim. DETYROHET paditësja Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” me seli në Prishtinë, që kësaj gjykate t’ia paguaj taksën gjyqësore në shumë prej 30€, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit Sh. S. av. nga Lipjani, t’ia paguaj shumën prej 239.20.-€, të gjitha në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit, për shkaqe të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimi të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa e të njëjtit të aprovohet si e bazuar ndërsa aktgjykimi i goditur me ankesë të prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim në shkallë të parë apo të refuzohet kërkesëpadia e paditësit si e pabazuar.

Në shkresa të lëndës nuk mund të gjendet se pala paditëse ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka vlerësuar se:

- Ankesa e përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, me datën 05.01.2018, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, duke kërkuar të detyrohet i padituri që paditëses t’i kompensoj shumën prej 2,463.00€, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 13.06.2014 në rrugën tranzitore Prishtinë- Lipjan, me kamatë ligjore, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit.

Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka dhënë vlerësimin se lidhur me mënyrën e vendosur si në dispozitiv, ngase i padituri, ka shkaktuar aksidentin e trafikut me automjetin e markës Renault Megana me targa 01-...-FS, në rrugën tranzitore Prishtinë-Lipjan, përderisa po drejtonte automjetin në mënyrë të pasigurt dhe të kundërligjshme (pa patent shofer), duke i shkaktuar kështu dëme materiale në automjetin “Suzuki” SX4 dhe lëndime të lehta trupore të dëmtuarit E. L., gjë e cila është vërtetuar me Raportin policor të evidentuar me shenjë 2014-AR-1282, të dt. 13.06.2014, provë kjo të cilës gjykata ia fali besimin, nga se gjatë tërë procedurës i padituri nuk ofroj asnjë kundërprovë me të cilin do të zhvlerësoheshin këto prova. Po ashtu, gjykata ka ardh në përfundim se i padituri përveç se ka qenë fajtor për shkaktimin e aksidentit në kohën kur është shkaktuar aksidenti, i njëjti nuk ka poseduar patent shofer, gjë të cilën e ka humbur mbulesën siguruese valide të automjetit me të cilin e ka shkaktuar aksidentin. Ndërsa në anën tjetër pjesëmarrësi në komunikacion përkatësisht pala e dëmtuar tashmë është kompensuar në tërësi nga pala paditëse, apo se pala paditëse i kishte kompensuar personat e tretë përmes ujdisë jashtëgjyqësore dhe atë i kishte paguar shumën e përgjithshme prej 2.463.00€. Si rrjedhojë, i padituri F. J. si shkaktar i aksidentit, bazuar në Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, dhe për vozitje pa patent shofer, për dëmin

e shkaktuar të dëmtuarit (tashmë të paguar nga ana e palës paditëse), ka për obligim që të njëjtën shumë t'ia regresojë këtu paditëses. Andaj, bazuar në këto fakte, gjykata ka konstatuar se në rastin konkret i padituri detyrohet që paditëses në emër të regresimit të dëmit të paguajë shumën prej 2.463.00€ si dhe shpenzimet e procedurës për përfaqësues të përkohshëm në shumë prej 239.20-€, dhe për taksë gjyqësore shumën prej 30-€.

Për mënyrën e vendosjes, gjykata e shkallës së parë është bazuar në dispozitat ligjore nga neni 136 i LMD-së e lidhur me nenin 10 dhe 18 i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (Ligji Nr. 04/L-018), neni 14.1.2 të Ligjit për sigurimin e obligueshëm nga autopërgjegjësia si dhe neni 14.3 të LSDA-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së neni 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të palës së paditur se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore pasi që aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë janë dhënë arsye. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Gjykata përmes provave të siguruara nga pala paditëse në këtë rast Raporti Policor mbi aksidentin datë 13.06.2014, ka vërtetuar faktin e ndodhjes së aksidentit të trafikut, i cili ka ardhur derisa vetura "A" (F. J.) ishte duke lëvizur në drejtim të rrugës Shtime- Prishtinë dhe me të rritur në afërsi të objektit "Auto Loni" në Lipjan nuk e përshtat shpejtësinë e lëvizjes së automjetit që drejtonte me kushtet e rrugës humb kontrollin ndaj automjetit dhe fillon të bartet duke kaluar ën shiritin e kundërt të rrugës dhe duke e rrezikuar kështu automjetin "B" (E. L.), i cili ishte duke lëvizur në drejtim Prishtinë- Shtime, i cili për t'iu shmangur goditjes së drejtpërdrejtë del nga rruga në anën e djathtë. Pala paditëse këtu ka lidhur ujdj jashtëgjyqësor me të dëmtuarin dhe nga transferi bankar rezulton se të dëmtuarit i është paguar shuma prej 2,463.00€, fakt që dëshmohet përmes urdhërtransferit bankar që gjendet në shkresa të lëndës. Këtë shumë pala paditëse e kërkon nga shkaktuesi i aksidentit përkatësisht nga drejtimi i automjetit të pasiguar dhe atë në emër të rimbursimit të dëmit që i është paguar palës së dëmtuar. Po ashtu përmes Aktgjykimit P.nr.368/2014, i datës 19.12.2014, është vërtetuar se i padituri ishte shpallë fajtor për aksidentin e shkaktuar, në të cilin aktgjykim është vërtetuar se pala që paditësja kishte kompensuar kishte pësuar lëndime trupore. Nga analizimi i thënieve në ankesë, nuk është gjendur se cilat ishin ato prova që gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar në mënyrë të gabuar, në atë mënyrë që ka keqinterpretuar përmbajtjen e tyre, apo se nuk është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, duke bërë të njohur për këtë gjykatë se një prove e caktuar do të dërgonte tek një gjendje tjetër faktike.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, gjykata e shkallës së parë ka arritur që të bëjë kualifikimin në harmoni me të drejtën materiale. Gjykata e Apelit vlerësoi pretendimin ankimor në mënyrën e elaboruar nga pala ankuese, për sa i përket aplikimit të së drejtës materiale, ndonëse për këtë gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, duke gjetur si pretendim të pa bazuar, ngase gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të njëjtën. Kjo gjykatë gjen se në kuptim të nenit 14 par. 1 pika 1.2 të Ligjit nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia përcaktohet se: *I siguruari e humbë mbulesën siguruese, kur drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimeve të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimit.* Kurse par. 3 i të njëjtit nen përcakton: *Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese.* Rrjedhimisht paditësja ka të drejtë të kërkojë regres nga shkaktari i dëmit i cili nuk kishte patent shofer.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d) lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
Ac.nr.1774/2022, datë 11.03.2024

Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari
Dardan Kadolli